



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 31, datë 9/10.2019

PËR

**“RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në zbatim të nenit 38 funksionet e Senati Akademik, pika 3 dhe Nenit 69 e në vijim të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 3.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik”, të ndryshuar”, nisur nga kërkesat e Dekanëve të Fakultetit të Muzikës dhe Fakultetit të Artit Skenik mbi rialokimin e kuotave të miratuara nga Senati Akademik me VSA Nr. 15, datë 09.04.2019, dhe VSA Nr. 16, datë 09.04.2019, të Universitetit të Arteve dhe më konkretisht shkresave të FM, Nr. 303 Prot, datë 09.10.2019; FAS, Nr. 428 Prot, datë 09.10.2019, Senati Akademik pasi diskutoi mbi “Kërkesat mbi rialokim të kuotave të miratuara të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor për vitin akademik 2019-2020, në Universitetin e Arteve”.

V E N D O S I:

1. Rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor, për vitin akademik 2019-2020, në Universitetin e Arteve për aplikimin e maturanëve në raundin e tretë, pa prekur vendet e ngelura bosh në portalin U-Albania nga dy raundet e para të zhvilluara në UART, si më poshtë:
  - Programi i studimit Violinë cikli i parë i studimeve Bachelor **3 (tre)** kuota.
  - Programi i studimit Kanto cikli i parë i studimeve Bachelor **9 (nëntë)** kuota.
  - Programi i studimit Pedagogji Muzikore cikli i parë i studimeve Bachelor **2 (dy)** kuota.
  - Programi i studimit Kompozicion cikli i parë i studimeve Bachelor **1 (një)** kuotë.
  - Programi i studimit Fizarmonikë cikli i parë i studimeve Bachelor **1 (një) kuotë, nga Trojet.**
  - Programi i studimit Aktrim cikli i parë i studimeve Bachelor **2 (dy)** kuota.
  - Programi i studimit Regji Filmi dhe TV cikli i parë i studimeve Bachelor **1 (një)** kuotë
  - Programi i studimit Koreografi cikli i parë i studimeve Bachelor **1 (një) kuotë nga Trojet.**

